

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6592
E mërkurë, 27 prill 2022
çmimi 0.40 €

MSh-ja: Pandemia
nuk ka mbaruar,
vaksinohuni **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTIT DIALOGU PO I RRËSHQET NË PRIORITET TË PARË **FAQE 4-5**



Kryeministri Albin Kurti, në ditët e para kur është zgjedhur kryeministër, pati thënë se dialogu Kosovë - Serbi do të jetë i radhitur si prioritet i gjashtë apo i shtatë për t'u marrë me të. Dalëngadalë ky premtim i tij ka ndryshuar ndërkohë. Pas presioneve të vazhdueshme të BE-së dhe të ShBA-së, si duket kryeministrit Kurti dialogu Kosovë - Serbi është duke i rrëshqitur në prioritet të parë. Këtë e vërteton edhe deklarata e fundit e ndihmësekretares amerikane të Shtetit për Evropë dhe Euroazi, Karen Donfried, e cila në Prishtinë ka thënë se çështja e dialogut është urgjente

AKTUALE



ABAZOVIOI PARAQET PROGRAMIN E PUNËS SË QEVERISË SË RE **F. 2**

POLICIA E KOSOVËS SULMOHET SËRISH NË VERI **F. 3**

'THIRRJET PËR LIBERALIZIM VIZASH PËR KOSOVËN PO HASIN NË VESHË TË SHURDHËR' **F. 5**

EKONOMI



FMN-ja I MUNDËSON KOSOVËS QASJE NË ALOKIMIN E TËRHEQJES SDR **F. 8**

MINISTRIA E BUJQËSISË HAP PERIUdhËN E APLIKIMIT PËR SUBVENCIONE **F. 8**

SPORT



'PLAY-OFF'-I FILLON ME NDESHJEN PEJA - BASHKIMI **F. 10**

Gjykata e Apelit kthen në rigjykim rastin e 'Veteranëve' **FAQE 3**



PDK-ja PARAQET SHIFRAT: KOSOVA MË SHUMË KA SHITUR SESA KA BLERË RRYMË GJATË KRIZËS ENERGETIKE **FAQE 8**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Varhelyi: Shtyrja e integrit të Ballkanit nuk është në interes të BE-së

SOFJE, 26 PRILL - Komisionari i Bashkimit Evropian për Zgjerimin, Oliver Varhelyi, ka bërë thirrje për zgjidhjen e kontestit në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, që të hapet rruga për nisjen e bisedimeve të Shkupit dhe Tiranës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Në Forumin për Marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, që u mbajt të martën në Sofje, komisionari Varhelyi tha se "jam jashtëzakonisht i zhgënjyer që ende po flasim për fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Mendova se e zgjidhëm këtë çështje dy vjet më parë, por kjo tani është kthyer në tryezë".

Varhelyi theksoi se BE-ja nuk ka as kohë dhe as interes që t'i shtyjë konferencat e para ndërqeveritare me Shkupin dhe Sofjen. "Të gjitha shtetet anëtare duhet të kuptojnë fuqinë transformuese të procesit të anëtarësimit. Dhe ky është mesazhi që po sjell përsëri në Sofje. Kam qenë këtu para tre javësh dhe do të vij sa të jetë e nevojshme për ta zgjidhur këtë çështje në qershor të këtij viti,



sepse lufta në Ukrainë na ka treguar se nuk kemi kohë për të humbur dhe as interes që ky proces nuk vonohet", tha ai. Sipas tij, "lufta në Ukrainë dhe mësimet e së kaluarës kanë treguar se procesi i integrit të plotë të Ballkanit Perëndimor në BE duhet të përshpejtohet".

Por, pavarësisht kërkesës së komisionarit të BE-së për

Zgjerimin dhe Politikën e Fqinjësisë së Mirë, Oliver Varhelyi, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes Shkupit dhe Sofjes, ministrja e Punëve të Jashtme të Bullgarisë, Teodora Gençovska, përsëriti se vetoja bullgare për Shkupin nuk do të hiqet pa u përmbushur kërkesa për përfshirjen e pakicës bullgare në Kushtetutën e

Maqedonisë së Veriut. "Është kusht i deklaratës së Kuvendit kombëtar bullgar dhe është konfirmuar nga Këshilli Konsultativ për Sigurinë Kombëtare. Në këtë fazë është e rëndësishme që ky kusht të plotësohet para fillimit të negociatave", ka deklaruar Gençovska në Forumin për Marrëdhëniet ndërmjet

Bashkimit Evropian dhe Ballkanit në Sofje.

Kundërshtimet e Sofjes, kryeministri maqedonas Dimitar Kovaçevski i ka vlerësuar si luftë politike mes partive bullgare për shkak të paqëndrueshmërisë së qeverisë bullgare. "Lufta politike në një vend fqinj, shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe retorika populiste - nacionaliste nuk mund të jenë pengesë për anëtarësimin e një vendi që ka katër raporte radhazi për ta nisur konferencën e parë ndërqeveritare", ka deklaruar në Shkup kryeministri Kovaçevski. Bullgaria, si shtet anëtar i BE-së, në nëntor të vitit 2020 ka përdorur veton për ta bllokuar Maqedoninë e Veriut për nisjen e bisedimeve të anëtarësimit evropian. Sofja konteston gjuhën dhe identitetin maqedonase duke kërkuar nga Shkupi që të pranojë "rrënjët bullgare" në identitetin e tyre. Bullgaria, gjithashtu, kërkon respektimin e të drejtave të bullgarëve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut duke kërkuar përfshirjen e tyre në kushtetutën e këtij vendi si popull shtetformues.

Abazoviqi prezanton programin e punës së qeverisë së re

PODGORICË, 26 PRILL - Shtylla kyçe e Qeverisë së re të Malit të Zi do të jenë sundimi i ligjit dhe zhvillimi ekonomik, tha mandatarin për kryeministër, Dritan Abazoviq, në ekspozenë e dorëzuar në Kuvendin e Malit të Zi.

Qeveria e re e këtij vendi pritet të zgjedhet në një seancë parlamentare, që do të mbahet më 28 prill në Cetinë.

Atë pritet ta përbëjnë Lëvizja Qytetare URA e Abazoviqit, Partia Popullore Socialiste, e cila është pro-serbe, Partia Socialdemokrate dhe partitë kombëtare të shqiptarëve dhe boshnjakëve.

Qeveria e re pritet të ketë 46 deputetë, nga 81 sa ka gjithsej Kuvendi i Malit të Zi.

Qeveria pritet të ketë mbështetje parlamentare edhe nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e presidentit malazez Millo Gjukanoviq.

Por, ajo kundërshtohet fuqishëm nga Fronti Demokratik pro-serb dhe pro-rus, si dhe Demokratët - dy subjekte që kanë përbërë koalicionin e deritashëm qeveritar.

Në ekspozenë e Abazoviqit



thuhet se në tremujorin e parë të punës së qeverisë së re është planifikuar një projektligj për regjistrimin e popullsisë në përputhje me standardet evropiane.

Regjistrimi i popullsisë shkakton tensione në Mal të Zi, sepse për një pjesë të opinionit politik ai

nuk është çështje statistikore, por çështje e regjistrimit kombëtar dhe fetar.

Në fushën e prioritetëve të politikës së jashtme, Abazoviqi përmend formimin e Ministrisë së Çështjeve Evropiane, me qëllim të, siç thuhet, koordinimit dhe komunikimit më të mirë me

strukturën negociatore të BE-së. "Unë besoj se Mali i Zi mund të kërkojë një pranim të përshpejtuar [në BE] dhe se me vendime urgjente, por të mençura, mund të bëhet anëtar i plotë së shpejti", tha Abazoviq. Në mesin e prioritetëve të qeverisë së tij përmendet edhe

marrëveshja për bartësit e funksioneve gjyqësore, pastaj Ligji për origjinën e pronës, reforma zgjedhore, rishikimi i gjendjes aktuale në arsim dhe kulturë e të tjera.

Abazoviqi është propozuar për kryeministër të Qeverisë së re të Malit të Zi më 3 mars nga presidenti i këtij vendi, Millo Gjukanoviq.

Paraprakisht, mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë së deriatëhershme ka kaluar në Kuvend me votat e URA-s së Abazoviqit dhe të opozitës së udhëhequr nga DPS-ja e Gjukanoviqit. Qeveria e rrëzuar, e udhëhequr nga kryeministri Zdravko Krivokapiq, është formuar në dhjetor të vitit 2020 nga një koalicion mes Frontit Demokratik, Demokratëve dhe Lëvizjes Qytetare URA.

Kjo qeveri ka pasur një shumicë të ngushtë në Kuvend - prej 41 deputetësh - por ka kthyer DPS-në në opozitë pas tri dekadash. Dallimet në qëndrime midis partnerëve të koalicionit kanë nisur të shpërfaqen shumë shpejt pas formimit të tij dhe palët shpesh nuk kanë qenë të njëzëshme në vendime.

Policia e Kosovës sulmohet sërish në veri


“Epoka e re”

PRISHTINË, 26 PRILL - Policia e Kosovës ka bërë me dije se të martën në orët e hershme të mëngjesit është sulmuar me armë zjarri një njësi patrulluese kufitare e saj në Zupçe të Zubin Potokut. Sipas saj, përveç dëmeve materiale në automjet, nuk ka raportime për zyrtarë policorë të lënduar. “Sot në orët e hershme të mëngjesit konfirmojmë se është sulmuar një njësi patrulluese kufitare në fshatin Zupçe të Zubin Potokut. Lidhur me rastin janë ndërmarrë të gjitha veprimet e menjëhershme policore, ku në vendngjarje kanë dalë edhe njësitet policore të rendit nga Stacioni Policor në Zubin Potok të cilat kanë njoftuar se njësi kufitar është sulmuar me armë zjarri. Përveç dëmeve materiale në automjet, nuk raportohet për zyrtarë të lënduar. Policia e Kosovës, në bashkëpunim

me organet e drejtësisë, janë duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore lidhur me rastin, përderisa ka shtuar masat policore me qëllim të sigurisë së zyrtarëve policorë dhe qytetarëve”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Nga 13 prilli autoritetet e Kosovës kanë regjistruar gjashtë sulme ndaj Policisë së Kosovës në veri të vendit, duke përfshirë edhe këtë të fundit. Megjithatë, ato nuk kanë treguar nëse kanë identifikuar ndonjë person përgjegjës për sulmet, mirëpo kanë pasur dyshime se të shtënat për disa prej tyre kanë ardhur nga territori i Serbisë.

Komunat në veri të Kosovës, si Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, janë të banuara me shumicë serbe. Në atë zonë ka pasur disa herë trazira, të fundit kanë ndodhur shtatorin e kaluar për shkak të disa mosmarrëveshjeve për targarat e automjeteve.



Kërkohet kushtëzimi i Serbisë për të ofruar të dhëna për të pagjeturit

PRISHTINË, 26 PRILL - Kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur në luftën e fundit në Kosovë, Andin Hoti, ka kërkuar të martën që bashkësia ndërkombëtare ta rrisë presionin dhe ta kushtëzojë Serbinë për të ofruar informacione për personat e pagjetur. “Kërkesa jonë e parë është kushtëzimi ndaj Serbisë. Kërkesa jonë e dytë ka qenë garancia e Bashkimit Evropian që të ketë një afat kohor kur Serbia detyrohet t'i japë informacionet për personat e zhdukur. Dhe kërkesa e tretë është për hapjen e të gjitha dokumenteve sekrete të Serbisë, të kohës së luftës në Kosovë”, ka thënë Hoti, teksa ka kryer homazhe te memoriali në Prishtinë kushtuar të pagjeturve. Dita e të Pagjeturve në Kosovë shënohet më 27 prill.

Ai ka thënë se së shpejti në Serbi pritet të fillojnë gërmimet në një tjetër lokacion.

Sipas Hotit, delegacioni i Kosovës u ka kërkuar shteteve mike tash e një vit për t'i siguruar imazhet satelitore



përmes Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Megjithatë, Hoti ka thënë se ende nuk kanë marrë ndonjë përgjigje.

Bajram Çerkini nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur u

ka bërë thirrje autoriteteve që të merren me këtë proces, mirëpo ka thënë se e di që “kjo çështje nuk do të kryhet shpejt”.

Kosova ka dalë nga lufta e vitit 1998-99, me mbi 13 000 persona të varrë,

mbi 800 000 të zhvendosur dhe mbi 5 000 të zhdukur.

Qindra shqiptarë të varrë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi, të cilët janë bartur nga forcat serbe për t'i fshehur

krimet.

Deri më tani nga Serbia në Kosovë janë kthyer mbetje mortore të rreth 1 000 personave.

Mbi 23 vjet pas luftës, të zhdukur vazhdojnë të jenë mbi 1 600 njerëz.

Një zyrtar i Bashkimit Evropian ka thënë më 25 prill se delegacionet e Kosovës dhe Serbisë janë afër arritjes së marrëveshjes për të pagjeturit në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga blloku evropian në Bruksel. “Sa i përket çështjes së të pagjeturve, praktikisht ka mbetur të zgjidhen vetëm dy fjalë, pra një gjysmë fjali, që ta kemi marrëveshjen”, ka thënë ky burim.

Në BE thonë se është e domosdoshme që të ketë shpejt marrëveshje, në mënyrë që të krijohen kushtet për takimin e nivel të lartë politik mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë, me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve mes dy vendeve, ka nisur më 2011.

Gjykata e Apelit kthen në rigjykim rastin e ‘Veteranëve’

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Departamenti Special i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, ka vendosur që ta aprovojë ankesën e Prokurorisë Speciale të Kosovës dhe ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë

lidhur me rastin “Veteranët”. Kësajsoj apeli ka vendosur që kjo çështje penale të kthehet në rigjykim dhe rivendosje të njëjtës gjykatë.

Agim Çeku, Rustem Berisha, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Çelë Gashi, Shukri Buja, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj, Xhavit

Jashari dhe Ahmet Daku akuzohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë procesit të verifikimit të listave të veteranëve të UÇK-së.

Me qëllim të informimit sa më të drejtë dhe të saktë në lidhje me këtë çështje penale, në shtojcë të kësaj komunikate gjendet aktvendimi i anonimizuar i





Kurtit dialogu po i rrëshqet në prioritet të parë

Kryeministri Albin Kurti, në ditët e para kur është zgjedhur kryeministër, pati thënë se dialogu Kosovë - Serbi do të jetë i radhitur si prioritet i gjashtë apo i shtatë për t'u marrë me të. Dalëngadalë ky premtime i tij ka ndryshuar ndërkohë. Pas presioneve të vazhdueshme të BE-së dhe të ShBA-së, si duket kryeministrit Kurti dialogu Kosovë - Serbi është duke i rrëshqitur në prioritet të parë. Këtë e vërteton edhe deklarata e fundit e ndihmëssekretares amerikane të Shtetit për Evropë dhe Euroazi, Karen Donfried, e cila në Prishtinë ka thënë se çështja e dialogut është

urgjente

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - 1. Dialogu Kosovë - Serbi, i lehtësuar nga Bashkimi Evropian, me përkrahje të fuqishme amerikane, është për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve me njohje reciproke; 2. Status quoja

është e paqëndrueshme; 3. Nga status quoja përfiton Kremlin; 4. Çështja e dialogut është urgjente. Këto ishin katër mesazhet që dha në Prishtinë ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Evropë dhe Euroazi, Karen Donfried, pas takimeve që ka pasur një ditë më parë me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Si duket kryeministrit Kurti dialogu Kosovë - Serbi është duke i rrëshqitur në prioritet të parë dhe jo siç kishte thënë më herët se do të jetë prioritet i gjashtë ose i shtatë. "Kjo temë renditet e gjashta ose e shtata midis prioriteteve të qytetarëve. Të gjitha sondazhet tregojnë se shqetësimet e tyre kryesore janë punësimi, ekonomia, drejtësia...

Sidoqoftë, unë jam i gatshëm të bëj një kompromis, për ta vendosur dialogun në rendin e tretë ose të katërt të përparësive të mia!", kishte thënë kryeministri Kurti.

Gjatë vizitës në Kosovë, ndihmëssekretarja amerikane e Shtetit për Evropë dhe Euroazi, Karen Donfried, bëri të qartë qëndrimin e ShBA-së në raport me dialogun. Madje përmendi edhe fjalën urgjencë për këtë proces dialogues. "Status quoja është e paqëndrueshme; jo vetëm që pengon të ardhmen evropiane të Kosovës dhe Serbisë, por është në dobi të Kremlinit. Rusia dëshiron të prishë çdo unitet dhe konsolidim demokratik në

vendet e Ballkanit Perëndimor, duke siguruar që ju dhe fqinjët tuaj nuk mund dhe nuk mund të integroheni në institucionet evropiane dhe euroatlantike. Ai beson se një rajon ballkanik më i fortë, më i begatë dhe elastik demokratikisht është një kërcënim për ndikimin e tij. Marrëdhëniet më të mira mes Kosovës dhe Serbisë kërcënojnë aftësinë e Rusisë për të përçarë, për të krijuar frikë dhe për të nxitur kaos. Mënyra më e mirë për t'i kundërshtuar përpjekjet flagrante të Kremlinit për ta destabilizuar rajonin është e thjeshtë: Kosova dhe Serbia duhet të bashkohen dhe të riangazhohen urgjentisht në dialogun e lehtësuar nga BE-ja,

Milaim Zeka lirohet nga akuza për mashtrim me viza

PRISHTINË, 26 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Milaim Zeka dhe dy të akuzuarve, I. K. dhe E. K., për veprat penale "mashtrim", "shmangie nga

tatimi" dhe "pastrim i parave". Aktgjykimin ndaj tre të akuzuarve është shpallur të martën nga gjykatësi Vesel Ismajli, raporton "Betimi për drejtësi".

Sipas këtij aktgjykim, tre të akuzuarit lirohen nga të

gjitha pikat e aktakuzës ngaqë nuk është provuar se kanë kryer veprat penale. Ndryshe, Prokuroria Speciale më 28 gusht 2018 ka ngritur aktakuzë me pretendimin se të pandehurit I. K., M. Z. dhe E. K. kanë kryer disa vepra

penale. I. K. dhe M. Z. akuzoheshin se prej vitit 2016 deri në mars të vitit 2017, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror më 2 qershor 2016, kishin krijuar biznesin "I.K & M.Z. Op" si agjenci punësimi.



'Thirrjet për liberalizim vizash për Kosovën po hasin në veshë të shurdhër'

Prishtinë, 26 prill - Presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola, e ka kritikuar Bashkimin Evropian për hezitimin që t'i liberalizojë vizat për Kosovën duke thënë se thirrjet e Parlamentit Evropian që kjo të bëhet, po hasin në veshë të shurdhër. Ajo këtë e ka thënë në një fjalim përmes videos në një konferencë për Ballkanin Perëndimor të zhvilluar në Bullgari. "Me gjithë faktin se i kanë përmbushur të

gjitha kërkesat tona, qytetarët e Kosovës vazhdojnë të kenë nevojë për viza për të hyrë në Bashkimin Evropian. Thirrjet e përsëritura të Parlamentit Evropian kanë hasur në veshë të shurdhër. Jo vetëm se kjo është e pandershme, por edhe e dëmton kredibilitetin e BE-së dhe na bën më të dobët", ka thënë ajo.

Metsola, po ashtu, ka kërkuar që të caktohet data për nisjen e negociatave të anëtarësimit me

Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ajo ka thënë se Serbia "seriozisht ka ngecur në përshtatjen e qëndrimeve të saj me ato të BE-së.

Presidentja e Parlamentit Evropian, Metsola, ka tërhequr vërejtjen se Rusia po tenton ta destabilizojë Ballkanin Perëndimor dhe BE-ja duhet të jetë vigjilente. "Fantazmat e luftës janë ende gjallë në Ballkan, por integrimi në BE do të sjellë një ajër të freskët

shumë të nevojshëm për të tejkaluar të kaluarën. Ky integrim është thelbësor për Ballkanin, por edhe për BE-në", ka thënë ajo.

Duke e quajtur procesin e zgjerimit të BE-së sukses të madh me fuqi transformuese, ajo ka përsëritur se Parlamenti Evropian do të vazhdojë të jetë mbështetës i madh i zgjerimit. Parlamenti Evropian për vite me radhë ka kërkuar liberalizimin e vizave për

Kosovën dhe nisjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në rastin e Kosovës, Parlamenti ka dhënë edhe pëlqimin e nevojshëm pas rekomandimit të Komisionit Evropian.

Por, qëndrimet e Parlamentit Evropian nuk janë ligjërisht obliguese për vendet anëtare të BE-së, e vendimet përfundimtare miratohen në Këshill pikërisht nga shtetet anëtare.



me mbështetjen e fuqishme të ShBA-së", ka theksuar Donfried. Për këtë deklaratë të zyrtares së lartë të ShBA-së ka pasur reagime nga opozita dhe shoqëria civile.

Anëtari i kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ish-ambasador i Kosovës në Londër, Muhamet Hamiti, ka thënë se pushteti 'Krejt dhe drejt', që e quante dialogun prioritet të gjashtë a të shtatë, si për të thënë s'është gjë kjo punë, tash po flet për 'urgjencë të dialogut'. "Ka mbledhur mend më në fund kjo kastë pushtetore, apo? E kemi thënë vazhdimisht këtë që e dëgjuan sot prej diplomates së lartë amerikane presidentja dhe kryeministri, por edhe populli i Kosovës, pas deklaratave publike: status quoja nuk i konvenon Kosovës. Serbisë dhe

Rusisë po, e kemi thënë përherë", ka deklaruar Hamiti.

Ndërkaq nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka thënë se po i vjen mirë që më në fund kryeministri Kurti po shpreh mirënjohje dhe respekt publik për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Neve, më herët, për qëndrime të bashkrenduara me ShBA-në, kryeministri i sotëm na ka etiketuar si tradhtarë, të nënshtruar e të shantazhuar. Por, këto qëndrime të kundërshtuara ashpër atëherë nga z. Kurti, i kanë sjellë Kosovës lirinë (përmes Rambujesë), i kanë sjellë pavarësinë (përmes procesit të Vjenës), dhe i ka sjellë MSA-në (përmes dialogut në Bruksel). Mes të tjerash, z. Kurti atëbotë ka pas thirrur edhe një konferencë të jashtëzakonshme për shtyp

për të denoncuar një shkëmbim letrash mes kryeministrit Taçi dhe sekretarit të përgjithshëm të NATO-s. E mos të flasin për zhurmat e paarsyeshme të z. Kurti lidhur me angazhimet e ish-sekretares Albright në mbështetje të Kosovës. Këto të fundit i kanë të publikuara në fletushkat e VV-së", ka deklaruar Çitaku.

Ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington tash ka disa pyetje për Kurtin pasi ka marrë pushtetin në raport edhe me dialogun. "Kryeministër, a jeni vendosur në linjë me ShBA-në, se dialogu me Serbinë për marrëveshje finale me njohje reciproke është çështje urgjente dhe se kërkon angazhim serioz edhe nga Kosova? Cili është qëndrimi juaj për marrëveshjen e Uashingtonit (marrëveshje të cilën e mbështet administrata

Biden)? Kryeministër, a e ke pasë gabim atëherë a tash?", ka pohuar Çitaku.

Analisti politik Ilir Ibrahimimi ka thënë se deklarata e ndihmësekretares amerikane të Shtetit për Evropë dhe Euroazi, Karen Donfried, se status quoja dhe vonesat në dialog shkojnë në favor të Rusisë, ishte mesazh i qartë dhe i drejtpërdrejtë që moti nuk e kemi dëgjuar. "Mesazh më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë moti nuk kemi parë. Mund ta imagjinojmë se edhe sa më i qartë mund të ketë qenë mesazhi në takime me liderët. Nuk ka se si të mos e kuptojnë udhëheqësit kosovarë këtë mesazh. E nëse edhe pas këtij mesazhi nuk guxojnë të veprojnë, atëherë me të vërtetë kjo është përtej çdo logjike. Sipas këtij mesazhi, lufta kundër interesave ruse bëhet në

tavolinën e bisedimeve dhe jo me intervista televizive, qofshin ato edhe të CNN-it", ka thënë ai. Ibrahimimi ka theksuar se nëse dikur liderët kosovarë kanë arritur që përballë tytës së pushkës së ushtrisë serbe të shkojnë dhe të arrijnë një marrëveshje në Rambuje, nuk ka asnjë kuptim që sot në kohë paqeje, përkrah fuqisë më të madhe ushtarake në botë, të hezitojnë. Koha për të vepruar është sot. Veprimi të rreshton me Amerikën. Mosveprimi me Rusinë. Kaq e thjeshtë është", ka thënë Ibrahimimi.

Albin Kurti sa ishte në opozitë vazhdimisht ka drejtuar akuza për procesin e dialogut me Serbinë. Kryeministrat e mëhershëm i akuzonte se po i nënshtroheshin Serbisë përmes dialogut.

Edhe Plluzhina kyçet në rrjetin e ujësjellësit

SKENDERAJ, 26 PRILL (ER) - Kanë përfunduar punimet në kuadër të projektit për kyçje individuale të shtëpive në rrjetin e ujësjellësit, të shtëpive në lagjet e fshatit Plluzhinë. Për ta parë nga afër procesin, në terren kanë dalë kryetari i komunës së

Skenderajt, Fadil Nura dhe drejtori për Shërbime Publike, Alban Shala.

Kryetari Nura është ndarë kënaqur me punimet dhe përfundimin e tyre, ku projekti në fjalë përfshin kyçjet e shtëpive në fshatrat Likoc, Makërmal,

Ticë, Plluzhinë dhe Rezallë.

Brenda pak ditësh pritet edhe testimi i furnizimit me ujë, për çka kryetari Nura ka bërë thirrje që ai të shfrytëzohet sa më racional. Ky projekt është bashkëfinansim i komunës së Skenderajt dhe CDI-s zvicerane.



Hapet ekspozita e librit në Podujevë

PODUJEVË, 26 PRILL (ER) - Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit po shënon Ditën Ndërkombëtare të Librit me ekspozitë në bibliotekën e qytetit. Të pranishëm në hapjen e kësaj ekspozite ishin

nënkryetarja e komunës, Marigona Lahu dhe drejtori i DKRS-së, Pajtim Balaj. Ekspozita e librit do të jetë e hapur për tri ditë. Nënkryetarja Lahu gjatë hapjes së ekspozitës ka thënë se po

shënojnë ditën ndërkombëtare të librit me hapjen e kësaj ekspozite, me qëllim të promovimit të rëndësishëm të leximit të gjitha gjeneratat. "Po zotohemi se si qeverisje komunale do të

angazhohemi për të krijuar kushte sa më të mira për lexuesit llapjanë", ka deklaruar ajo.

Drejtori Balaj ka thënë se gjatë këtij viti si DKRS kanë ndarë një shumë prej 20 000 eurove për ta pasuruar

fondin e bibliotekës së qytetit me tituj të rinj librash. "Këtë e kemi bërë në konsultim edhe me nxënësit, studentët dhe lexuesit e rregullt të bibliotekës", ka thënë Balaj.



Komuna e Rahovecit shpërndan makina mbjellëse të misrit, motokultivatorë dhe plugje

RAHOVEC, 26 PRILL (ER) - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Berat Duraku, kanë bërë shpërndarjen e dhjetë makinave mbjellëse të misrit

(pneumatike), njëzet motokultivatorëve dhe shtatë plugjeve dykrahëshe për bujqit e komunës së Rahovecit. "Që nga fillimi i mandatit tim, prioritet të veçantë i kam dhënë zhvillimit të bujqësisë dhe përkrahjes së bujqve

e kështu do të vazhdojmë edhe në të ardhmen me shërbime, lehtësira, vizita e ndihmën e çdoditshme të bujqve nga institucionet e komunës së Rahovecit", është shprehur kryetari Latifi.

Inspeksioni liron hapësirën e uzurpuar nga një lokal afarist në rrugën "Afrim Zhitia"

MITROVICE, 26 PRILL (ER) - Inspektorët komunalë kanë inspektuar një subjekt afarist në rrugën "Afrim Zhitia", me ç'rast kanë urdhëruar pronarin për lirim të hapësirës së uzurpuar publike. Sipas inspektorëve komunalë, personi përgjegjës i subjektit afarist ka vendosur aneksin me

shtylla metalike me gjatësi prej 12,00 x 3,60 metra, pa leje adekuate nga organet komunale.

Përveç mungesës së lejes kompetente, arsye shtesë pse është larguar konstrukcioni metalik ishte edhe vlerësimi i inxhinierit të ndërtimit, pasi që është objekt i vjetër dhe është amortizuar pllaka e

betonit, ndërkohë që shtyllat metalike kanë një peshë të rëndë. Me këtë rast, inspektorët komunalë e kanë obliguar personin përgjegjës që në afat të menjëhershëm ta largojë aneksin e vendosur dhe hapësirën publike ta kthejë në gjendje të mëparshme, përndryshe do të merren masa ligjore.



MSh-ja: Pandemia nuk ka mbaruar, vaksinohuni

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 PRILL - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se Kosova ka shënuar këtyre ditëve numër të vogël të rasteve të reja të Covid-19 dhe, për më tepër, prej disa javësh, fatmirësisht, nuk ka as raste të vdekjeve nga kjo sëmundje. Por, sipas MSh-së, në vende të ndryshme të botës, këtyre ditëve sërish janë regjistruar raste të shumta të Covid-19 sepse, sipas Ministrisë

së Shëndetësisë, pandemia Covid-19 nuk ka mbaruar. "Me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen të vaksinohen, me dozën e parë ata që ende s'e kanë bërë këtë, kurse të tjerët me dozën e dytë dhe dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë.

Kjo ministri ka njoftuar se të martën, pas 349 testeve, 7

qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të martën janë shënuar 13 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 224 431. Në total numri i rasteve aktive është 428.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 62 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 825 458 doza të



vaksinës. Deri më sot 821 788 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë

dhënë 101 226 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.

Mehaj: Përkrah ShBA-së, rruga jonë përpara është e sigurt

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur të martën në takim zëvendëskomandantin e Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM), gjeneraljejtënant Michael L. Howard me delegacionin e tij. Me këtë rast, ministri Mehaj ka shprehur kënaqësinë për vizitën e gjeneralit Howard duke e njoftuar me të arriturat e deritashme, proceset zhvillimore dhe objektivat për të ardhmen, gjithnjë me mbështetjen e pazëvendësueshme, bashkëpunimin dhe sinkronizimin e ngushtë me autoritetet politike dhe ushtarake amerikane. Nga ana e tij, gjeneral Howard ka

shprehur vlerësimin e lartë për të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së dhe ka siguruar për mbështetjen në proceset zhvillimore edhe në të ardhmen.

Ndër të tjera, të dy kanë diskutuar edhe për zhvillimet në kontekstin e ri gjeopolitik global, si dhe për reflektimin e tyre në mjedisin e sigurisë rajonale. "Republika e Kosovës qëndron fuqishëm përkrah ShBA-së dhe aleatëve të saj në rrugën e integritimit euroatlantike si dhe në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, kontinental dhe global", ka theksuar ministri Mehaj.



QKUK-ja: Mjekët i riaftësojnë dorën pacientit pas aksidentit që pësoi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 PRILL - Mjekët dhe infermierët e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë shpëtuar dorën e një pacienti nga Suhareka, i cili kishte pësuar lëndim të rëndë të krahut (gymtyrës) së sipërme të majtë.

Pacienti fillimisht ishte sjellë nga Suhareka në Klinikën Emergjente ku kishte marrë ndihmën emergjente mjekësore nga mjekët dhe stafi infermior i Klinikës Emergjente. Më pastaj, ekipi kujdestar i mjekëve, në përbërje të kirurgut vaskular, anesteziologut, kirurgëve plastikë dhe stafit infermior, hynë në operacion delikat që kishte zgjatur me orë të tëra.

Ekipi mjekësor arriti ta riaftësojë

gymtyrën - krahun e pacientit, i cili tani ka dorën e gjallë, me vaskularizim, të inervuar dhe të lëvizshme.

Pacienti kishte ardhur me të gjitha sistemet (sistemi neurovaskular, muskolor dhe ai i tetivave) të shkoputur nga vazhdimësia, me një defekt të madh të lëkurës.

Ndërsa lëndimi i strukturave ishte në një radiokarpale (kyçi i dorës), aty ku edhe kalibri i enëve të gjakut është milimetrik, e të cilat fillojnë të futen në shuplakë dhe kjo e vështirësoi në masë të madhe shpëtimin e ekstremitetit të pacientit, por rezikoi edhe jetën e tij. Lëndimet e tilla, amputimet traumatike, në literaturë janë të shoqëruara me shkallë të vdekshmërisë prej 72 %, ndërsa humbjet e ekstremiteteve janë me përqindje të lartë, mbi 90 %.

Dështon mbledhja e Komisionit për Arsim

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Në mungesë të anëtarëve ka dështuar mbledhja e Komisionit për Arsim. Pas vonës së tyre, anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) nuk i kanë pritur deputetët.

Në këtë komision kanë qenë të pranishëm anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim të cilët ishin ftuar për të raportuar për punën e tyre për vitin 2021.

Kryetarja e këtij këshilli, Hasnije

Ilazi, ka thënë se nuk mund të presin më shumë se 15 minuta. Ndërsa anëtarja e Komisionit për Arsim, Albena Reshitaj, ka thënë se, pavarësisht prej bojkotit të opozitës, shqyrtimi i raportit të KShC-së ka qenë i rëndësishëm.



PDK-ja paraqet shifrat: Kosova më shumë ka shitur sesa ka blerë rrymë gjatë krizës energjetike

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 PRILL - Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri dhe kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Ferat Shala, në një konferencë për medie kanë paraqitur të martën fakte që dëshmojnë se Kosova më shumë po eksporton sesa po importon energji elektrike, ndërkohë që qytetarët po detyrohen ta paguajnë energjinë e shpenzuar mbi 100 për qind më shtrenjtë.

Kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se gjatë dy muajve të fundit PDK-ja ka qenë jashtëzakonisht insistuese në kërkesën e saj për themelimin e komisionit hetimor për ta zbardhur të vërtetën për të gjitha çështjet rreth furnizimit me energji elektrike që nga dhjetori i vitit 2021. "Sot do t'i lëmë anash të gjitha argumentet tona politike dhe do të flasim

vetëm me numra, do ta japim një pasqyrë të qartë para qytetarëve të Republikës së Kosovës për gjendjen reale të shpenzimit të energjisë elektrike në Kosovë dhe nevojën për import", ka theksuar Tahiri.

Ai ka thënë se nga këto të dhëna zyrtare shihet se prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë e ka mbuluar kërkesën për konsum në muajt shkurt, mars dhe prill. "Në anën tjetër janë dyfishuar tarifat, janë ndarë 100 milionë euro për subvencionim. Pra ku po shkojnë këto mjete? Kjo po na intereson neve. Kjo i intereson komisionit hetimor dhe qytetarëve të Kosovës", ka potencuar Tahiri.

PDK-ja i ka bërë thirrje Lëvizjes Vetëvendosje dhe kryeministrit Kurti që të enjten mos ta bllokojnë themelimin e komisionit hetimor për energjinë.

Ndërkaq, deputeti dhe kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Ferat Shala, ka thënë



se shifrat dhe faktet tregojnë më së miri arsyeshmërinë e kërkesës së vazhdueshme për themelimin e Komisionit Hetimor për menaxhimin e krizës energjetike. "Si parti, si grup parlamentar dhe komision kemi kërkuar që urgjentisht të formohet komisioni hetimor. Këto kërkesa nuk do të

ndalen, përkundrazi, do të shtohen. Qytetarët e meritojnë të dinë të vërtetën. Pse po bllokohet themelimi i komisionit hetimor nga qeveria?", ka thënë Shala. Më tej, ai shtoi se kjo situatë dëshmon edhe paaftësinë e kësaj qeverie për t'u marrë me këtë problematikë. "Kjo situatë tregon

edhe paaftësinë institucionale në menaxhimin e krizës me energjinë, keqmenaxhimin e skajshëm të sektorit energjetik dhe, së fundmi, dëshmon haptazi edhe tentimin e qeverisë për ta fshehur të vërtetën në lidhje me këtë çështje", ka thënë deputeti Ferat Shala.

FMN-ja i mundëson Kosovës qasje në alokimin e tërheqjes SDR

PRISHTINË, 26 PRILL - Kosova vitet e fundit ka pasur avancim sa i përket bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare. Për këtë drejtoresha ekzekutive e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Kristalina Georgieva, e ka njoftuar guvernatorin Fehmi Mehmeti edhe për një mundësi për Kosovën. "Sot pranova letrën e nënshkruar nga drejtoresha ekzekutive e Fondit Monetar Ndërkombëtar, znj. Kristalina Georgieva, lidhur me alokimin e përgjithshëm të të drejtave të veçanta të tërheqjes (SDR). Drejtoresha ekzekutive ka theksuar bashkëpunimin e vazhdueshëm për t'i mbështetur të gjithë anëtarët me qëllim të tejkalimit të krizës dhe arritjen e një rimëkëmbjeje të qëndrueshme", ka shkruar Mehmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka thënë për RTK-në se kjo është arritje e madhe për Kosovën në aspektin politik, ekonomik, strategjik, gjeopolitik dhe integruar. "Është një dëshmi që ka avancim sa i përket



bashkëpunimit në mes të BQK-së dhe FMN-së si rezultat i këtij kooperimi mes dy institucioneve gjegjëse dhe transparencës së madhe është ndarë edhe SDR-ja. Kjo është e arritur për Kosovën dhe

sistemin financiar. Kosova që nga pas lufta ka pasur shumë suksese sa i përket anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, në këtë rast edhe anëtarësimi në FMN dhe Bankë Botërore janë të arritura të

mëdha", ka theksuar ai. Sipas Gërxhaliut, edhe pse kohë krize, siç kanë qenë pandemia dhe, së fundi, lufta në Ukrainë, BQK-ja ka treguar përkushtim të respektimit të udhëzimeve dhe

regullave që janë të vëna nga institucionet ndërkombëtare dhe për këtë është vlerësuar me SDR. "Kjo arritje për Kosovën dhe BQK-në është një dëshmi se kur ka transparencë dhe llogaridhënie, vlerësimi nuk do të mungojë", ka pohuar ai.

Çka është SDR

SDR është një aktiv rezervë ndërkombëtar, i krijuar nga FMN më 1969 për t'i plotësuar rezervat zyrtare të vendeve anëtare. Deri më sot janë ndarë një total prej 660.7 miliardë SDR (ekuivalente me rreth 943 miliardë dollarë amerikanë). Kjo përfshin alokimin më të madh ndonjëherë prej rreth 456 miliardë SDR të miratuar më 2 gusht 2021 (në fuqi më 23 gusht 2021). Kjo ndarje më e fundit ishte për ta adresuar nevojën afatgjatë globale për rezerva dhe për t'i ndihmuar vendet të përballen me ndikimin e pandemisë Covid-19. Vlera e SDR-së bazohet në prerje të pesë monedhave: dollarit amerikan, euros, yuanit kinez, jenit japonez dhe sterlinës britanike.

Ministria e Bujqësisë hap periudhën e aplikimit për subvencione

PRISHTINË, 26 PRILL (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur periudhën e aplikimit për pagesa direkte/subvencione për disa kultura dhe aktivitete bujqësore.

Periudha e aplikimit zgjatë 30 ditë kalendarike që nga dita e shpalljes publike, ndërkaq

aplikimi për të përfutur subvencione bëhet në zyrat e drejtorive komunale për bujqësi. Me rastin e fillimit të aplikimit, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit, Faton Peci, i ka ftuar fermerët nga gjithë territori i Republikës së Kosovës që të aplikojnë për mbështetje në kuadër të Programit të Pagesave

Direkte për vitin 2022. "Është hapur sot aplikimi për Programin e Pagesave Direkte/Subvencioneve 2022. Ky program arrin vlerën prej minimum 50 milionë eurosh dhe parashihet rritje të konsiderueshme për shumicën e kulturave bujqësore", ka thënë ministri Peci.



CIA i frikësohet efektit “Kabul”: Kujt do t’i mbetet arsenali i madh i armëve që po dërgon Perëndimi në Ukrainë?



Nga Gian MICALESSIN

Në selinë qendrore të CIA-s amerikane, Lengli, kanë nisur të bëjnë disa llogari, duke iu frikësuar fatit të armëve të shumta që janë dërguar dhe po dërgohen në Ukrainë. Në fillim të luftës, lista e armatimeve përfshinte vetëm furnizimet prej 2.7 miliardë dollarësh që mbërritën pas vitit 2014, dhe shtimin e rreth 200 milionë dollarëve ndihmë të cilën Xho Bajden e premtoi në dhjetorin e vitit të kaluar.

Pas pushtimit rus dërgesat u shtuan në mënyrë drastike. Sipas të dhënave zyrtare nga Pentagoni dhe Shtëpia e Bardhë, ngarkesa me vlerë 3.4 miliardë dollarë u nisën për në Kiev duke filluar nga 24 shkurti. Këtyre i shtohen 800

milionëve ndihmë shtesë të premtuara nga Bajden, dhe që do të shpërndahen duke nisur nga java e ardhshme.

Pra armë me vlerë rreth 7.1 miliardë dollarë, janë sot pjesë e arsenalit të ushtrisë ukrainse. Një ndihmë së cilës duhet t’i shtohen dërgesat që janë të barabarta me rreth 1.6 miliardë dollarë vetëm nga vendet evropiane, dhe mbi 550 milionë ndihmë e dhënë nga Britania e Madhe.

Pra mbi 9 miliardë dollarë armë, të cilat siç shpjegoi së fundmi në kushte anonimiteti një zyrtar i inteligjencës amerikane për CNN, askush nuk e di saktësisht se ku përfunduan apo si janë përdorur. Dhe kjo e panjohur nuk është një problem i vogël.

Sepse në Lengli nuk i kanë harruar problemet pas tërheqjes së Rusisë nga Afganistani në vitin

1989. Menjëherë pas dhe gjatë gjysmës së parë të viteve 1990, CIA u detyrua të gjurmonte dhe më pas të blinte raketat “Stinger” që mbetën në duart e muxhahidinëve, që rrezikonin t’i shiteshin grupeve terroriste apo vendeve armike që ishin të gatshme ta kopjonin teknologjinë e tyre.

Dhe rasti i Ukrainës nuk është i ndryshëm. Edhe për shkak se armët, pasi u shpërndahen emisarëve ukrainas që i presin në bazat e NATO-s në Poloni, Rumani dhe Sllovakia, humbin gjurmët shumë shpejt.

“Për një kohë të shkurtër ne mund të mbështetemi tek një besnikëri e caktuar. Por kur ngarkesat e armëve hyjnë në zonën e luftës, kjo besnikëri reduktohet në zero. Armët përfundojnë shumë shpejt në një

vimë të zezë të madhe, nga e cila nuk del asnjë informacion”- shpjegojnë për CNN burimet e inteligjencës amerikane.


Kjo deklaratë bën të qartë se NATO, Shtetet e Bashkuara dhe Britania nuk kanë asnjë kontroll mbi destinacionin dhe përdorimin e këtyre dërgesave. Nga këtu burojnë edhe shqetësimet e drejtuesve të CIA-s. Nëse qoftë edhe vetëm një numër i vogël raketash antitank apo kundërajrorësh do të binte në duart e grupeve jashtë kontrollit të ushtrisë ukrainse, Evropa do ta gjente veten përballë një kërcënimi shumë tinëzar brenda kufijve të saj.

Ndonjë nga grupet e ndryshme nacionaliste dhe ekstremiste të angazhuar aktualisht në anën e Kievit, pas një armëpushimi të mundshëm, mund t’i përdorë ato

armë në përpjekje për të kapur pushtetin. Për shkak të këtyre paqartësive, sipas burimeve të inteligjencës që kanë folur për CNN, bëhet shumë e rrezikshme që të plotësohen të gjitha kërkesat që vijnë nga Volodimir Zelenski dhe qeveria e tij.

“Ata janë në luftë dhe çdo gjë që bëjnë apo thonë publikisht, synon që t’i japë avantazh dhe fitoren e luftës”- shpjegojnë burimet e CNN, që kujtojnë se në çdo konflikt, shqetësimi kryesor i atyre që gjenden të rrethuar është t’i garantojnë vetes ndihma gjithnjë e më të konsiderueshme ushtarake. Pikërisht për këtë arsye, ata që i furnizojnë duhet të mos harrojnë se në të ardhmen këto armë mund të përdoren kundër tyre. / “Il Giornale” – Bota.al





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

'Play-off'-i fillon me ndeshjen Peja - Bashkimi



PRISHTINË, 26 PRILL - Në mesjavë fillon faza e "play-off"-it në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll, ku zhvillohet sfida e parë çerekfinale. Në takimin e parë do të përballen Peja dhe Bashkimi. Pejanët përfunduan në vendin e tretë me 18 fitore e dhjetë humbje, kurse prizrenasit në vendin e gjashtë me 12 fitore e 16 humbje. Këto dy skuadra u përballën katër herë në edicionin e rregullt, ku tri herë fituan verdhezinjtë, kurse një herë portokallezinjtë. Pejanët janë të motivuar pasi fituan Ligën Unike dhe e duan trofeun e dytë, kurse prizrenasit shpresojnë të kualifikohen në gjysmëfinale. Sfida e dytë është ndërmjet Prizrenit 16 dhe Sigal Prishtinës, që pritet të jetë

mjaft interesante. Të dyja skuadrat përfunduan garat e rregullta me 15 fitore e 13 humbje. Në duelet direkte mes tyre, tri herë fituan prizrenasit, ndërsa një herë prishtinasit. Në gjysmëfinale kualifikohen skuadrat që shënojnë dy fitore. Golden Eagle Ylli në gjysmëfinale e pret fituesin e ndeshjes Prizreni 16-Sigal Prishtina, kurse Trepça e pret fituesin e ndeshjes Peja-Bashkimi.

Prishtina e Re - Rahoveci garojnë për Superligë

Prishtina e Re dhe Rahoveci do të përballen në "play-out" për një vend në elitën e basketbollit në edicionin e ardhshëm. Prishtinasit ishin

finalistë të "play-off"-it në Ligën e Parë të meshkujve, ku pësuan nga Vëllaznimi i Gjakovës, që siguroi rikthimin në Superligë, ndërsa Rahoveci përfundoi garat në vendin e shtatë në Art Motion Superligë dhe do të luftojë të mbetet në elitën e basketbollit. Sfida e parë do të zhvillohet të mërkurën në kryeqytet, ndërsa skuadra që siguron rezultat më të mirë nga të dyja përballjet do të sigurojë një vend në elitën e basketbollit për edicionin e ardhshëm. Kryeqytetasit janë të motivuar, pasi do të ishte hera e parë që do të luajnë në Superligë, ndërsa "vreshtarët", që garuan edhe në Ligën Unike, synojnë të mbesin pjesë e elitës së basketbollit.

SHKURT

Trajneri i Mallorcas: Nuk e di a do ta blejmë Muriqin

Trajneri Javier Aguirre ka folur në lidhje me të ardhmen e Vedat Muriqit te Mallorca. Siç raportojnë mediet italiane, Aguirre ka zbuluar detaje në lidhje me huazimin e Muriqit. "A do t'i paguajmë 12 milionë euro për transferimin e tij? Nuk mund të flas për supozime. Duhet të presim që të përfundoj sezoni dhe të shohim se çfarë do të bëjmë", është shprehur Aguirre. "Pesë sulmuesit që kemi janë të ndryshëm dhe çdo kombinim është i mirë. Ai që ka luajtur më shumë është Muriqi, sepse është i emocionuar me golin dhe është shumë i motivuar", ka shtuar ai. Muriqi në ndeshjet e fundit është rikthyer në formë të lartë, ku ishte protagonist në dy prej tri përballjeve të fundit.

Klubi i Kosovës ia ofron 15 mijë euro trajnerit nga Shqipëria

Orges Shehi tani është në qendër të vëmendjes. Prej javësh trajneri i Tiranës ka në tavolinë një ofertë shumë të mirë. Një skuadër nga Kosova i ka afuar 15 mijë euro që ai së bashku me stafin e tij të drejtojnë një ekip të BKT Superligës dhe ta sjellin titullin kampion. Oferta është shumë e mirë dhe është një nga të shumtat, ndërsa Orges Shehi kërkon ta vazhdojë punën te Tirana dhe do ta vazhdojë, raporton "PanoramaSport". Gjithsesi, trajneri i ka kërkuar kohë më parë presidentit Refik Halili dy gjëra teknike: ta ruajë grupin, pra t'i rinovojë kontratat me lojtarët pa kontratë, por edhe të ketë një skuadër kompetitive për sezonin e ri. Pra, që të mos ketë largime. Edhe nëse ka largime ekstra, pra për shitje, Shehi kërkon nga klubi që t'i zëvendësojë me lojtarë të vlefshëm dhe të njëjtë me ata që ka pasur. Këto janë kushtet teknike të Shehit, i cili e mori skuadrën një vit e gjysmë më parë dhe që në sezonin e dytë solli titullin te bardheblutë.

Nora Gjakova dhe Lorian Kuka mungojnë në Kampionatin Evropian të Xhudos

PRISHTINË, 26 PRILL - Kanë mbetur vetëm edhe tri ditë deri në Kampionatin Evropian për seniorë që mbahet nga data 29 prill deri më 1 maj në Sofje të Bullgarisë. Kosova vitin e kaluar kishte përfunduar në vendin e parë në tabelë nga 45 shtete, me 2 medalje të arta të fituara nga

Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova dhe 1 të bronzit nga Nora Gjakova. Xhudistët nga Kosova tashmë kanë krijuar një precedent të arritjes së sukseseve në gara ndërkombëtare, por në këtë kampionat do të mungojnë dy xhudistët Nora Gjakova dhe Lorian Kuka.

Lajmin për "KosovaPress" e ka konfirmuar trajneri Driton Kuka i cili ka thënë se dy xhudistët janë duke u rikuperuar nga lëndimet. "Të enjten do të hidhet shorti. Ne do të paraqitemi me katë xhudistë në këtë kampionat. Kësaj radhe do të mungojnë Nora Gjakova

dhe Lorian Kuka sepse po vazhdojnë të rikuperohen nga lëndimet që i kanë", ka thënë Kuka. Si rrjedhojë, këtë vit në Kampionatin Evropian për Seniorë nga Kosova do të marrin pjesë Distria Krasniqi (-52kg), Flaka Loxha (-57kg), Laura Fazliu dhe Akil Gjakova.



Altin Merlaku, 'ylli i javës' në Superligë

KLINË, 26 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ndarjen e çmimit "ylli i javës". Ky çmim për xhiron e 30 në BKT

Superligë i ka takuar futbollistit të KF Dukagjini (Klinë), Altin Merlaku. Kapiteni i skuadrës klinase pati paraqitje të shkëlqyeshme në fitoren e skuadrës së tij ndaj tifozëve të vet

kundër Gjilanit me rezultat 2-0. Merlaku realizoi të dyja golat në fitoren tejet të rëndësishme të skuadrës së Armend Dallkut në luftën për mbijetesë. Pas kësaj fitoreje Dukagjini i rrit shpresat për

t'u shmangur pozitës që dërgon në barazh. Aktualisht ka 36 pikë, aq sa ka edhe Drenica në pozitën e 7-të. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e Dukagjinit e dorëzoi Endrit Zenunaj, specialist në BKT.



17-vjeçari Elion Bobani po e përfaqëson denjësisht Kosovën në garat e 'CrossFit'-it

PRISHTINË, 26 PRILL - Elion Bobani është nga Gjakova dhe prej katër vjetësh merret me sportin e "CrossFit"-it. "CrossFit" është një sport i ri në botë, që ka nisur të zhvillohet edhe në Kosovë. Është sport ku ushtrohen të gjitha aspektet fizike si: forca, shpejtësia, shkathhtësia, qëndrueshmëria, fleksibiliteti etj. Në "CrossFit" përfshihen tri disiplinat kryesore: Peshëngritja olimpike, gjimnastika dhe cardio. "Unë kam filluar me 'CrossFit' prej katër vjetësh. Në këtë sport më ka njoftuar babai im, Leonardi. Në fillim ushtroja për të qenë i shëndetshëm, pasi kam vuajtur nga bronikiti kronik, ndërsa pas një kohe, kur u njoha më shumë për sportin, fillova të përgatitem për gara", ka thënë Elioni për Komitetin Olimpik të Kosovës.

Që prej fillimit të garave vitin e kaluar, 17-vjeçari ka nisur t'i vargojë sukseset. "Vitin e kaluar në fazën e parë të garave ndërkombëtare mora titullin 'Fittest Teen' në Kosovë (në grupmoshën 16-17 vjet) dhe 'Fittest Man' në Kosovë (divizioni 18+). Kurse në fazën e dytë, në



renditjen botërore, përfundova i 27-ti, kurse në Evropë i katërti", ka shtuar Bobani.

Rezultatet në këtë sport nuk merren vetëm në bazë të ngritjes së peshave, por edhe nga qëndrueshmëria, fleksibiliteti dhe shpejtësia, të cilat i posedon Elioni. Statistikat e tij në këtë sport janë: "Deadlift": 200 kg, "Snatch": 115 kg, "Back Squat": 170 kg dhe "Clean And Jerk": 130 kg. Dalëngadalë apetitet për rezultate të mira në

këtë sport u shtuan dhe në garat e fundit të këtij viti, ai arriti deri në çerekfinale. "Jam renditur i 32-ti në botë dhe nuk kam arritur të hyj në gjysmëfinale. Synimet e mia ishin të hyj në finale të 'CrossFit Games', që është niveli më i lartë i garave në këtë sport. Sidoqoftë, synoj që me punë edhe më të madhe të arrij këtë nivel". Ditë më parë, një video të tij gjatë përgatitjeve, e shpërmdau edhe faqja zyrtare e "CrossFit" në rrjetin social "Instagram".

Bostoni, gjysmëfinalisti i parë, Toronto rihap garën me Philadelphian

BOSTON, 26 PRILL - Bostoni është ekipi i parë gjysmëfinalist i "play-off"-it në NBA. Skuadra e Celticsit mposhti me rezultat 116-112 Brooklynin, duke fituar 4-0 serinë e çerekfinaleve. Një zhgënjim për Netsin, që e nisi sezonin ashtu si laktersat favoritë, por që u ndalën herët. Tatum me 29 pikë, Brown me



22 e Smart me 20 ishin vendimtarë në fitoren e Bostonit, duke i bërë të pavlefshme 39 pikët e Kevin Durantit për Brooklynin. Toronto fitoi me rezultat 103-88 në fushën e Philadelphias dhe rihap garën për në gjysmëfinale. Philadelphia udhëheq 3-2 serinë, ndërkohë që

kanadezët kanë fituar dy përballjet e fundit. Ndeshja u dominua nga Toronto, ku u dallua Siakam me 23 pikë e 10 rebounde. 3-2 udhëheq edhe Dallasi, që mundi 102-77 Utah Jazzin. Ndeshje e mirë për Luka Donqiqin, që realizoi 33 pikë e 13 rebounde për teksanët.

KONFERENCA E LINDJES - ÇERKFINALE "PLAY-OFF"

Miami - Atlanta	(3-1)
Philadelphia - Toronto	88-103 (3-2)
Milwaukee - Chicago	(3-1)
Boston - Brooklyn	116-112 (4-0)

KONFERENCA E PERËNDIMIT - ÇERKFINALE "PLAY-OFF"

Phoenix - New Orleans	(2-2)
Dallas - Utah Jazz	102-77 (3-2)
Golden State - Denver	(3-1)
Memphis - Minnesota	(2-2)

Chiellini më 1 qershor pensionohet nga Italia

Mbrojtësi 38-vjeçar i Italisë, Giorgio Chiellini, duket se ka marrë vendimin për t'u tërhequr nga kombëtarja "Axurre", pas sfidës me Argentinën. Chiellini është

shprehur se fundi i tij me kombëtaren do të jetë data 1 qershor, kur Italia do të përballet me Argentinën në një sfidë midis dy kampionëve kontinentalë të Evropës dhe

Amerikës Latine, që do të luhet në "Wembly". "Është normale që kur je 38 duhet të ndalosh dhe të kuptosh disa gjëra. Nëse do të jem mirë, do të luaj dhe do të them

lamtumirë në Wembly, aty ku arrita kulmin e karrierës time. Le të lëmë pak vend për djemtë e rinj që po vijnë", ishin fjalët e kapitenit të Juventusit dhe kombëtares

italiane, i cili më pas do të vendosë nëse do të largohet nga "Zonja" për në Shtetet e Bashkuara, apo do të qëndrojë dhe për një sezon me bardhezinjtë.

SHKURT

Cardiffi i kërkon Nantesit 80 milionë paund dëmshpërblim për Emiliano Salan

Futbollisti argjentinas, Emiliano Sala, u nda nga jeta në një mënyrë tragjike në vitin 2019, pas një përplasje me avionin, kur po udhëtonte në Britaninë e Madhe për të firmosur me klubin e tij të ri, Cardiff City. Po atë vit Cardiff ra nga Premierë Liga me vetëm dy pikë diferencë nga Brajtoni që doli në vendin e 17 dhe trajneri asaj kohe i ekipit, Neil Uarnok, besonte se sulmuesi do ta ndihmonte ekipin për ta përmbushur objektivin. Duket se tani Cardiff City ka marrë një vendim, duke i kërkuar si dëmshpërblim 80 milionë paund klubit të Nantesit, që beson se i humbi nga sponsorët si pasojë e rënies nga kategoria. Siç bën me dije "The Sun", klubi nga Uellsit e ka apeluar këtë çështje në CAS duke i kërkuar Nantesit ta mbajë përgjegjësinë për vdekjen e Emiliano Salas, pasi agjenti i tij, Uilli MekKej, zgjodhi avionin në emër të klubit francez, gjë që më pas solli vdekjen e futbollistit.

Pochettino dëshiron të largohet nga PSG-ja

Mauricio Pochettino dëshiron të largohet nga PSG-ja pasi përvoja me këtë skuadër nuk i ka shkuar ashtu siç ka pritur. "Le Parizien" i ka dhënë më shumë fuqi vendimit të 50-vjeçarit i cili, nëse u jep lamtumirën ish-kampionëve të Francës, drejtuesit e tyre duhet ta rikompensojnë me 15 milionë euro për arsye të prishjes së kontratës së cilës i mbetet edhe një vit për t'u finalizuar. Së fundmi është përfolur për disa kandidatë, ndër të cilët prioritet konsiderohej Zinedine Zidane, i preferuari i Nasser Al Khelaifit. Fillimisht Paris St Germain duhet t'i japë zgjidhje të menjëhershme qëndrimit ose jo të Mauricio Pochettinos i cili ka treguar se nuk është ende në nivelin e fitimit të Ligës së Kampionëve pavarësisht se ka në dispozicion lojtarët më të mirë në planet.

Pogba largohet nga grupi i ekipit në 'Whatsapp'

Sezoni i Paul Pogbas ka përfunduar për shkak të problemit në pulpë që mori në ndeshjen ndaj Liverpoolit dhe, gjithashtu, janë të shumtë ata që mendojnë se francezi ka mbyllur kapitullin me fanellën e Manchester Unitedit. "Daily Mirror" raporton se ish-lojtari i Juventusit ka njoftuar në dhomat e zhveshjes se nuk do ta rinovojë kontratën e tij me "Djajtë e Kuq". Pogba, gjithashtu, është larguar nga grupi i "Whatsapp"-it në të cilin janë të pranishëm shokët e ekipit. Për mesfushorin francez interes të madh po tregon ekipi i PSG-së.

Gjokoviqi mund të marrë pjesë në Wimbledon

Tenisti serb Novak Gjokoviq mund të marrë pjesë në Wimbledon pasi që Anglia ka hequr kufizimet për vaksinimet kundër koronavirusit. Fituesi i 20 Grand Slameve, Gjokoviq, i cili e ka bërë të qartë se nuk është i vaksinuar kundër virusit, nuk u lejua të merrte pjesë në Australian Open për shkak të vaksinimit dhe u dëbua nga vendi. 34-vjeçari do të jetë gjithashtu në gjendje të konkurrojë në French Open pasi organizatorët në Paris po ashtu hoqën të gjitha kufizimet për Covid. Turneu i këtij viti do të zhvillohet nga data 27 qershor deri më 10 korrik.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +383(0)390/321 588
+383(0)390/324 034
+383(0)46 19 55 55
www.cabrati.com
e-mail.info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr. 68/2022 dhe nr. Protokolli 700 i datës 26.04.2022, Kryeshefi Ekzekutiv vendosi që me datë 27.04.2022 të Ri shpallet :

Konkurs publik

Për këtë pozitë

1 /një/ INKASANTË me kohë të caktuar, me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

Kushtet:

1. Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme,
2. Të ketë më së paku 1 (një) vit përvojë të punës relevante,

Kushtet e veçanta:

1. Të ketë njohuri profesionale ose të ngjashme,
2. Të mos jetë i dënuar apo nën hetime,
3. Të ketë aftësi të mira psikofizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës,
4. Preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, , Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurren , Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i/e dënuar (më e re se gjatë muaj), preferohet të posedoj patentë shoferin me "B" kategori dhe Letër Njoftimi.

Detyrat e punës:

- Përfaqësimi dinjitozë i Ndërmarrjes para konsumatorëve;
- Dhënia e informatave të sakta lidhur me kohën e kryerjes së shërbimit në zona të caktuara;
- Të ketë aftësi komunikuese dhe sjellje të mira me konsumatorët;
- Të mbajë evidencë me shkrim dhe të njoftojë mbikëqyrësin për çdo ndryshim eventual të amvisërive dhe bizneseve për zonën e caktuar të mbulueshmërisë së tij/saj, si dhe të bëjë kategorizimin e tyre;
- Të lidhë kontrata mbi shërbimet me ekonomitë familjare (amvisëritë), si dhe të njoftojë në kohë reale për hapjen e bizneseve të reja për zonën e caktuar të mbulueshmërisë së tij/saj;
- Pranimi i faturave, shpërndarja e faturave tek konsumatorët, si dhe barazimi në baza ditore sipas inkasimit;
- Të dorëzojë raport të rregullt të punës në baza javore tek mbikëqyrësi i tyre;
- Të respektojë orarin e punës siç përcaktohet nga Ndërmarrja;
- Kryen edhe punë dhe detyra të tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit.

Afati i paraqitjes së kërkesave për këtë pozitë është 15 ditë nga dita e publikimit, (nga data 27.04.2022 e deri me datë 04.05.2022 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacione të kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek zyra e Menaxherit të Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë. Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues Deklaro saktë tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar të deklarojnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te kategoritë, si: Nën-deklaruesit e pagave të punëtorëve, nën-deklaruesit tek bizneset e mesme dhe të mëdha, nën-deklaruesit te bizneset mikro dhe të vogla, me qëllim të identifikimit të atyre bizneseve, të cilat nën deklarojnë të ardhurat e tyre.

Disa nga veprimtaritë si në vijim, nuk zbatohen këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të deklarojnë apo korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor:

- Identifikimi i bizneseve, të cilat nën-deklarojnë pagat e punëtorëve;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim, në veçanti veprimtaritë, si: tregti, shërbime, ndërtimtari dhe prodhim;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht në kuotën fikse prej 37.5€ në çdo 3 muajt;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht nën pragun e TVSH-së, veçanërisht bizneset në veprimtaritë, si: tregti, shërbime profesionale, zbatimëse-artistike, prodhim, transport, etj;
- Identifikimi i bizneseve, të cilat operojnë me humbje, si dhe bizneseve që deklarojnë me zero;
- Identifikimi i bizneseve të cilat ofrojnë furnizime pa të drejtën e kreditimit të TVSH-së, ndërsa në anën tjetër zbrasin TVSH-në në blerje;
- Identifikimi i bizneseve të cilat importojnë apo tregtojnë mallra me akcizë, të cilët përmes dokumentacionit jo të saktë, respektivisht nënvlërësimin të çmimeve të shitjes, i'u shmangen detyrimeve tatimore;
- Identifikimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e tekstilit dhe veshmbathjeve, të cilat mbajnë dokumentacione jo të sakta me qëllim të shmangies së detyrimeve tatimore;
- Identifikimi dhe trajtimi i personave, të cilët nuk bëjnë deklarimin e të ardhurave të ndryshme që ata mund të kenë qoftë të hyrat nga jashtë vendit, të hyrat nga kapitali apo të hyrat tjera; etj.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Paguaj tatimin, fuqizo shtetin!

Administrata Tatimore e Kosovës

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shpëtim Golaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".
- ▶ Baton Ferizi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI,XII dhe diplomën e SH.M.T. "Nexhmedin Nixha" Elektronik Informatikë.
- ▶ Lumturie Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F.M.U. "Ali Hasi" Crmjan KK Gjakovë. Nga kl.I,VIII.
- ▶ Lulzim Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. "Ali Hasi" Crmjan KK Gjakovë, nga kl. I,VIII.
- ▶ EM-EM. SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810823212 nrb. 70919044.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



KONKURS

1. Shpallet konkurs publik për punë dhe detyra specifike për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:

- **Pozita e punës:** Konsulent Ligjor
- **Numri i pozitave:** 1 (një)
- **Kohëzgjatja e punës:** 120 ditë
- **Paga bruto:** Në bazë të Rregullores për Paga.

2. **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Këshillon dhe jep mendime në cilësinë e ekspertit për Kryeshefin Ekzekutiv;
- Jap propozime për politikë të Ndërmarrjes për plane të performancës së stafit;
- Bashkëpunon ngushtë me Zyrën Ligjore dhe atë të Burimeve Njerëzore sipas kërkesës së Kryeshefin Ekzekutiv;
- Përpilon dokumente ligjore nga fusha dhe kompetenca në cilësinë e Ekspertit Ligjorë;
- Kryen punë dhe detyra tjera të kërkuara nga Kryeshefi Ekzekutiv.

3. **Kualifikimet dhe aftësitë:**

- Diplomë universitare në Fakultetin Juridik dhe të ketë provimin e Jurisprudencës;
- Nëse diploma është e fituar jashtë vendit të jetë e nostrifikuar;
- Dëshmi mbi eksperiencën e gjatë në fushën ligjore dhe atë të resurseve humane;
- 3 vite përvojë punë në menaxhim të dëshmuar përmes Trust-it;
- Zotërim të shkëlqyeshëm të gjuhës Angleze (në të folur dhe të shkruar);
- Aftësi të mira komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në presion;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft Office (Word, Excel, Outlook).
- Të mos jetë duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale ndaj aplikuesit.

4. **Dokumentacioni i kërkuar:**

-Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com;

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust.
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

-- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data **27.04.2022** dhe përfundon më datë **11.05.2022** në ora 24:00

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



JOB VAKANCIES

1. A public vacancy is announced and the following are specific job vacancies in the enterprise:

- **Job position:** Legal Consultant
- **Number of positions:** 1 (one)
- **Duration of work:** 120 days
- **Gross Wage:** According to the Wage Regulation.

2. **Duties and responsibilities:**

- Advises and gives opinions in the capacity of expert for the Chief Executive Officer;
- Provides Enterprise policy proposals for staff performance plans;
- Cooperates closely with the Legal and Human Resources Office at the request of the Chief Executive Officer;
- Compiles legal documents from the field and competencies in the capacity of Legal Expert;
- Performs other tasks and duties required by the Chief Executive Officer.

3. **Qualifications and skills:**

- University degree at the Faculty of Law and have a Jurisprudence exam;
- If the diploma is obtained abroad to be nostrified;
- Evidence of long experience in the field of law and human resources;
- 3 years of work experience in management proven through the Trust;
- Excellent command of English (spoken and written);
- Good communication skills and be ready for work under pressure;
- Good technology skills, Microsoft Office programs (Word, Excel, Outlook).
- No criminal proceedings are being conducted against the applicant.

4. **Required documentation:**

- The candidate must submit these documents in scanned form by email: punesimi@trafikurban-pr.com;
- Employment application (downloaded from TU website: <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacion-shq.html>);
- Evidence of schooling;
- Copy of ID card;
- Evidence of proven work experience with the Trust;
- Evidence from the competent court that no criminal proceedings are being conducted against him / her, not older than 6 months;
- Copies of other certificates related to the position you are applying for are an advantage;

- Any refutation of the material, whether intentional or by negligence or change of material from the information provided in the above statement will result in immediate disqualification.

General information:

- All citizens without distinction have the right to apply for this competition.
- The enterprise offers equal opportunities, encourages and promotes the engagement of workers, members of all communities and of different genders.
- Written testing and interviews will be done after the deadline for application according to law.

How to Apply:

The application can be made only via email: punesimi@trafikurban-pr.com

The competition is open from 27.04.2022 and ends on 11.05.2022 at 24:00

Note: Incomplete, unscanned documents and those that arrive after the competition deadline will not be considered.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



KONKURS

1. Raspisuje se javni konkurs i to su konkretni konkursi za radna mesta u preduzeću:

- Radno mesto: Pravni Konsultant
- Broj pozicija: 1 (jedan)
- Trajanje rada: 120 dana
- Bruto plata: Prema Uredbi o platama.

2. **Dužnosti i odgovornosti:**

- Savetuje i daje mišljenja u svojstvu stručnjaka za glavnog izvršnog direktora;
- Daje predloge politike preduzeća za planove učinka osoblja;
- Blisko saraduje sa Službom za pravne i ljudske resurse na zahtev glavnog izvršnog direktora;
- Sastavlja pravne akte iz oblasti i nadležnosti u svojstvu pravnog stručnjaka;
- Obavlja druge poslove i dužnosti koje zahteva glavni izvršni direktor.

3. **Kvalifikacije i veštine:**

- Univerzitetska diploma Pravnog fakulteta i položen pravosudni ispit;
- Ako je diploma stečena u inostranstvu da se nostrificira;
- Dokaz o dugogodišnjem iskustvu u oblasti prava i ljudskih resursa;
- 3 godine radnog iskustva u menadžmentu dokazano kroz Trust;
- Odlično poznavanje engleskog jezika (govorno i pismeno);
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad pod pritiskom;
- Dobre tehnološke veštine, Microsoft Office programi (Word, Excel, Outlook).
- Protiv podnosioca prijave se ne vodi krivični postupak.

4. **Potrebna dokumentacija:**

- Kandidat mora dostaviti ovc dokumente u skeniranom obliku na mejl: punesimi@trafikurban-pr.com;
- Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <http://www.trafikurban-pr.com/shk/job-aplikacion-shk.html>);
- Dokaz o školovanju;
- Kopija lične karte;
- Dokaz o dokazanom radnom iskustvu sa Trustom.
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost;

- Svako opovrgavanje materijala, bilo namerno ili iz nemara ili izmerna materijala u odnosu na informacije date u gornjoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

- Preduzeće nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovira angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

- Pismeno testiranje i intervju će se obaviti nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

Kako se prijaviti:

Prijava se može izvršiti samo putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com

Konkurs je otvoren od 27.04.2022 i završava se 11.05.2022 u 24:00

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti i oni koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek "REB BULLI", në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:

044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

